

V E N D I M
“PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK”

Në Tiranë sot më datë 29/02/1999, unë gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Tiranë Enxhela Cepo mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Z. Nazif Klosi për regjistrimin si person juridik të shoqërisë “KLOSI” Sh.p.k.

K O N S T A T O V A

se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Z. Nazif Klosi për regjistrimin si person juridik të shoqërisë “KLOSI”, Sh.p.k. për ushtrimin e aktivitetit privat në fushën:

- ◆ Nxjerrja dhe tregtimi i mineraleve të ndryshme (krom etj.) brënda dhe jashtë vendit, eksport, import. Tregtimi me shumicë dhe pakicë i produkteve industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, pyjore, të ndërtimit, bimëve medicinale, eksport – import i tyre.
 - ◆ Projektim në fushat gjeologo – minerale, gjeologo – inxhinjerike etj.
 - Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë.
 - Selia e shoqërisë është: Burrel.
 - Kohëzgjatja e shoqërisë është mbi 10 vjet.
 - Administrator i shoqërisë është Nazif Klosi.
 - Ortaku i vetëm i shoqërisë është Nazif Klosi.
- është e drejtë dhe duhet pranuar.

P Ë R K Ë T Ë A R S Y E

Në bazë të ligjit 7667 datë 28/01/1993 dhe ligjit 7638 datë 19/11/1992

V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik të shoqërisë “KLOSI”, Sh.p.k. për ushtrimin e aktivitetit privat në fushën:

- ◆ Nxjerrja dhe tregtimi i mineraleve të ndryshme (krom etj.) brënda dhe jashtë vendit, eksport, import. Tregtimi me shumicë dhe pakicë i produkteve industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, pyjore, të ndërtimit, bimëve medicinale, eksport – import i tyre.
 - ◆ Projektim në fushat gjeologo – minerale, gjeologo – inxhinjerike etj.
 - Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë.
 - Selia e shoqërisë është: Burrel.
 - Kohëzgjatja e shoqërisë është mbi 10 vjet.
 - Administrator i shoqërisë është Nazif Klosi.
 - Ortaku i vetëm i shoqërisë është Nazif Klosi.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim në shkallë të dytë.

G J Y Q T A R E

Enxhela Cepo
Cz

V E N D I M
I GJYQARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 29-4 une Gjyqtare e Gjykates se shkalles se pare Tirane
6.710 mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi:
- Nazif Klosi per depozitim prane regjistrimit te vendimit te ortakut te vetem te shoqerise tregtare "KLOSI" sh.p.k. dhe:

KONSTATOVA

Me vendimin Nr. 20758 date 20.02.1999 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "KLOSI" sh.p.k.

Me vendimin Nr. 1 date 22.04.2004 te ortakut te vetem te shoqerise "KLOSI" sh.p.k. eshte vendosur te shtohet objekti i veprimtarise ne fushen e :

- Perdorimit, te lendes plasese dhe shperthyese, pasi te paiset me liçense nga organet kompetente.
- Hoteleri Turizem, Bar – kafe – restorant.
- Tregetim me shumice e pakice te mallrave elektroshtepiake, hidraulike, hidrosanitare e elektronike.
- Transport mallrash brenda e jashte vendit.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992, te Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993:

V E N D O S A


Pranimin e kerkeses.

Depozitim prane regjistrimit tregtare te Gjykates te vendimit Nr. 1 date 22.04.2004 te ortakut te vetem te shoqerise "KLOSI" sh.p.k. ku eshte vendosur te shtohet objekti i veprimtarise ne fushen e :

- Perdorimit, te lendes plasese dhe shperthyese, pasi te paiset me liçense nga organet kompetente.
- Hoteleri Turizem, Bar – kafe – restorant.
- Tregetim me shumice e pakice te mallrave elektroshtepiake, hidraulike, hidrosanitare e elektronike.
- Transport mallrash brenda e jashte vendit.

Urdherohet zyra e regjistrimit tregtare te beje ndryshimet perkatese ne skeden e shoqerise.

GJYQTARE



URDHER REGJISTRIMI

Lo. 75B

Me

1.

2.a

Teloni 16 p.u

b.

100 000 lek.

c.

Waxaji dhe xepelima e
univerzitetit te natyshum. sh.

e.

Banuel. detyrimi i mbarimit

3.

te ortaku dhe komunikata
te vete neqyt. Teloni

4. Statuti nenshkruar me date

8.02.99.

5. Data

e regjistrimit 09.02.99.

Statuti

4

Fieci

Njoftime: a shoqeria

b. dhomen e tregtise

c. organit perkates financiar

d. zyres se statistikes

Publikime:

GJYQTARE

Dimitris Capi
Cv



AKT THEMELIMI

NENI 1

Nazif Klosi, lindur më 1960 në Burrel - Mat dhe banues në qytetin e Burrelit, sot më datë _____ 1999, ka vendosur që shoqëria e tij të marrë formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin "Për shoqëritë tregtare"

NENI 2

Shoqëria vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në përputhje me dispozitat e statutit që i bashkangjitet kësaj kontrate.

NENI 3

Emri i shoqërisë është "KLOSI" Sh.p.k.

NENI 4

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

- ◆ Nxjerrja dhe tregtimi i mineraleve të ndryshme (krom etj.) brënda dhe jashtë vendit, eksport, import. Tregtimi me shumicë dhe pakicë i produkteve industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, pyjore, të ndërtimit, bimëve medicinale, eksport – import i tyre.
- ◆ Projektim në fushat gjeologo – minerale, gjeologo – inxhinjerike etj.

NENI 5

Qendra dhe selia e shoqërisë është: Burrel. Ajo mund të zhvillojë veprimtarinë e saj në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jasht saj.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë. Shumat e derdhura për formimin e kapitalit do të vërtetohen me anë të një dokumenti të lëshuar nga banka.

NENI 7

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë kohe mbi 10 vjet.

NENI 8

Administrator i shoqërisë do të jetë ortaku i vetëm Nazif Klosi.

ORTAKU I VETËM

Nazif Klosi



Neni 9 **Libri i shoqërisë**

Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe mardhëniet e punës, Shoqëria do çelë librin e vet, i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

Neni 10 **Konfidencialiteti**

Ortaku i vetem si dhe personat e tjerë të pranuar në Shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do t'i disponojë Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

Neni 11 **Dokumentet e destinuarra për të tretët**

Të gjitha aktet dhe dokumentet që nxirren nga Shoqëria dhe të destinuarra për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj. duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "Sh.P.K.", si dhe emrin e administratorit.

KAPITULLI IV

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT DHE TRANSFORMIMI I TYRE

Neni 12 **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetëm. Shoqëria mund t'a shtojë ose zvogëlojë kapitalin, në varësi të nevojave dhe të rezultateve të saj, sipas vendimit të ortakut të vetëm.

Neni 13 **Kontributet**

Kapitali themeltar përbëhet nga kontributi i mëposhtëm:

Z. Nazif Klosi ka derdhur shumën prej 100.000 (njëqindmijë) lekë.



Neni 14

Pjesët e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar është i ndarë në 100 pjesë plotësisht të shlyera me vlerë 1000 (njëmijë) lekë secila, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 deri në 100.

Neni 15

Lënja dhe transferimi i pjesëve të kapitalit

Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë, në qoftë se ortakut i vetëm vendos për këtë. Ai mund të lihet peng sipas legjislacionit në fuqi, gjithashtu kapitali themeltar është lirisht i trashëgueshëm në rrugë trashëgimie. Bashkëshortja, paraardhësit dhe pasardhësit mund të bëhen ortakë nëpërmjet transferimit të kapitalit themeltar, me vendim të ortakut të vetëm dhe sipas kushteve që lejohen me ligj.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me akt noterial.

KAPITULLI V

STRUKTURA, ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 16

Ortaku i vetëm

Si organ i vetëm drejtues i shoqërisë është ortakut i vetëm, me iniciativën dhe kapitalin e të cilit vepron Shoqëria.

Neni 17

Kompetencat e ortakut të vetëm

Për sa kohë që Shoqëria do të përbëhet nga një ortak i vetëm, kompetencat e tij do të jenë:

Vendos për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe përpilon ose miraton rregulloret për Shoqërinë apo për sektorë të veçantë të veprimtarisë.

Emëron dhe shkarkon administratorët e Shoqërisë dhe detajon kompetencat e tyre të përcaktuara në Statut.

Kur e shikon të nevojshme emëron drejtorin ekzekutiv të Shoqërisë apo të sektorëve të vecantë të saj, duke caktuar në akt të emërimit dhe kompetencat e tij, kohëzgjatjen në punë etj.



STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "KLOSI"

KAPITULLI I

EMËRTIMI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI

Neni 1 Emërtimi

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "KLOSI" Sh.p.k., e cila më poshtë do të quhet Shoqëria, krijohet nga ortakut i vetëm, si themelues, z. Nazif Klosi, lindur më 1960 në Burrel - Mat dhe banues në qytetin e Burrelit.

Neni 2 Forma

Kjo shoqëri është një shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe i përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së kapitalit themeltar.

Neni 3 Baza juridike

Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe, si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij Statuti. Ajo fiton personalitetin juridik pas regjistrimit në Regjistrin Tregtar, në Gjykatën e Rrethit, Tiranë.

Neni 4 Selia

Selia e Shoqërisë do të jetë në Burrel.

Me vendim të ortakut të vetëm selia mund të ndryshohet.

Shoqëria do ta konsiderojë qendrën e vet si Shoqëria Nënë, e cila rast pas rasti do të hapet me anë filialesh ose shoqërish të përbashkëta në të gjitha ato vënde ku do të shikojë interes në përmbushjen e qëllimit të saj, në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.



Neni 5
Territori

Shoqëria e zhvillon aktivitetin në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI II

OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 6
Objekti

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- ◆ Nxjerrja dhe tregtimi i mineraleve të ndryshme (krom etj.) brënda dhe jashtë vendit, eksport, import. Tregtimi me shumicë dhe pakicë i produkteve industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, pyjore, të ndërtimit, bimëve medicinale, eksport – import i tyre.
- ◆ Projektim në fushat gjeologo – minerale, gjeologo – inxhinjerie etj.

Neni 7
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në Ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

KAPITULLI III

**AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQËRISË,
KONFIDENCIALITETI**

Neni 8
Fusha e autoritetit të ortakut

Fusha e autoritetit të ortakut të vetëm dhe përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë, si dhe kompetencat që gëzon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë Statut.





Shqyrton bilancin vjetor, përcakton llojet e fondeve të ndryshme dhe masën e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendos për marrjen e kredive.

Vendos për krijimin e degëve (filialeve) ose të përfaqësive si dhe për krijimin e shoqërive me persona të tjerë fizikë apo juridikë.

Vendos për mbarimin e Shoqërisë dhe likuidimin e saj.

Vendos për pagat e të punësuarve në Shoqëri.

Përveç kompetencave të lartpërmendura, të cilat janë ekskluzive për të, ortaku i vetëm, në rastet kur nuk ka emëruar administrator, kryen dhe kompetencat që në këtë Statut janë përcaktuar për këtë të fundit.

Neni 18

Administratori dhe kompetencat e tij

Kompetencat e administratorit ose të administratorëve, në mënyrë konkrete dhe të detajuar përcaktohen në aktin e emërimit të tyre. Veç të tjerave që mund të detajohen në këtë akt, administratori ka edhe këto kompetenca:

Kujdeset për funksionimin e përditshëm normal të Shoqërisë ose të një pjese të aktivitetit ekonomik dhe financiar të saj, sipas përcaktimit në aktin e emërimit.

Përgatit dokumentacionin dhe aktet e ndryshme për gjëndjen ekonomike dhe financiare të Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe i a paraqet ortakut të vetëm për shqyrtim.

Koordinon veprimtarinë e personave të punësuar në Shoqëri.

Shqyrton ofertat dhe përgatit kërkesa të cilat i a paraqet ortakut të vetëm për miratim.

Ndjek problemet e Shoqërisë në mardhëniet me organet shtetërore ose cakton ndonjë prej personelit për trajtimin e këtyre problemeve. I propozon ortakut të vetëm pagat për personelin e punësuar në Shoqëri.

I propozon ortakut të vetëm rregulloret për sektorë të vecantë të Shoqërisë. Emërimi i administratorit do të bëhet për një afat prej 3 (tre) vitesh financiarë, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm. Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve, qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të Statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij.

KAPITULLI VI

LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, DIVIDENTET

Neni 19

Librat e Shoqërisë

Shoqëria është e detyruar të mbajë, përveç librit të Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakut dhe kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakut të vetëm, edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.



Neni 20 **Bilanci**

Bilanci mbyllet më 31 dhjetor të cdo viti, ku i pari do të jetë 31 dhjetori i vitit 1999.
Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar nga ortaku, miratohen nga ortaku i vetëm.
Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brënda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 21 **Dividentët**

Ortaku i vetëm miraton llogaritë vjetore dhe evidenton ekzistencën e fitimit.
Ai përcakton fitimin e vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën sipas ligjit ose të përcaktuar nga vet ortaku; fondet e tjera që shihen të nevojshme dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e bartura nga vitet e mëparshme. Kështu ortaku i vetëm përcakton dhe dividentin.

KAPITULLI VII

MBARIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 22 **Mbarimi**

Shoqëria mbaron me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

Neni 23 **Likuidimi**

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku i vetëm cakton një ose disa likuidues, të cilët i paraqesin atij raportin mbi gjëndjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të procesit të likuidimit ortaku i vetëm vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit.

Pas pagimit të kreditorëve ortaku i vetëm mban pjesën e mbetur të kapitalit.



KAPITULLI VIII

MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 24

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likudimit do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare.

Neni 25

Dispozitat e fundit

Shoqëria do të ketë vulën e saj, forma dhe madhësia e së cilës do të përcaktohen nga ortaku i vetëm.

Ky Statut është hartuar në 4 (katër) ekzemplarë, duke patur secili ekzemplar fuqi të njëjtë ligjore.

Ortaku i vetëm

Nazif Klosi

20758/2

KERKESË

26 PRILL 2004
Bajram

KERKUESI

Nazif Klosi administrator i shoqerise
tregetare " KLOSI " shpk banues ne Burel

OBJEKTI

Depozitimin prane rregjistrarit tregetar te
Gjykates te vendimit te ortakut te vetem
te shoqerise tregetare " KLOSI " shpk.

GJYKATES E SIKALLES SE PARE

TIRANE

Q. detyrat qe duhet te...

Me vendimin nr. 20758 date 09.02.1999 eshte
rregjistruar si person juridik shoqeria tregetare " KLOSI "

Me vendimin e ortakut te vetem nr. 1 date
27.04.2004 te shoqerise tregetare " KLOSI " shpk eshte
vendpsur te shtohet objekti i veprimtarise se shoqerise.

Kerkojne depozitimin e ketij vendimi prane
rr gjistrarit tregetar te Gjykates.

KERKUESI
NAZIF KLOSI

Klosi

REPUBLIKA E SHQIPERISE


NOTERIA E TIRANES

Nr. 2221 Rep

Tirane ,me 22.04.2004

VERTETIM


Vertetohet se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi
per depozitimin e vendimit te ortakut te vetem te shoqerise
"KLOSI " SHPK u nenshkrua ne prezencen time nga kerkuesi Nazif
Klosi per indetitetin e te cilas u sigurova nga dokumenti
indatifikues dhe une notere e vertetetoj sipas ligjit.



V E N D I M

Nr. 1 date 22.04.2004

I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGETARE " KLOSI " SHPK



Une Nazif Klosi ortak i vetem dhe administrator i shoqerise tregetare " KLOSI " SHPK ne mbledhjen time te dates 22.04.2004 kam vendosur te shtoje objektin e veprimtarise se shoqerise ne fushen e :

Perdorimit te lendes plasese dhe shperthyese, Ne fushen e bar kafe, restorant,Hoteleri turizem,Tregetimin me shumice e pakice te mallrave elektroshteplake,hidraulike, hidrosanitare elektronike. Transport mallrash brenda dhe jashte vendit.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
TREGETARE " KLOSI " SHPK
NAZIF KLOSI

REPUBLIKA E SHQIPERISE


NOTERIA E TIRANES

Nr. 1278 Rep


Tirane ,me 24.04.2004

VERTETIM

Vertetohet se vendimi i ortakut te shoqerise tregetare " KLOSI " SHPK u nenshkrua ne prezencen time ortakut Nazif Klosi per indetitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti indetifikues dhe une notere e vertetoj sipas ligjit.



Notere
N O T E R E
E R O D H E T E



KËRKESË

KËRKUESI: Z. Nazif Klosi, i biri i Hajredinit, lindur më 1960 në Burrel-Mat dhe banues në Burrel.

OBJEKTI: Kërkesë për regjistrimin si person juridik të shoqërisë "KLOSI" Sh.p.k. *So. 758*

GJYKATËS SË RRETHIT TIRANË

Une, Nazif Klosi, ortak i vetëm i shoqërisë "KLOSI" Sh.p.k. në përputhje me legjislacionin në fuqi, kam krijuar me aktin e themelimit të datës _____ 1999, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

1. Emërtimi i shoqërisë është "KLOSI" Sh.p.k.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë.
3. Selia e shoqërisë është në Burrel.
4. Kohëzgjatja e shoqërisë është mbi 10 vjet.
5. Administrator i shoqërisë është Nazif Klosi.
6. Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:
 - ◆ Nxjerrja dhe tregtimi i mineraleve të ndryshme (krom etj.) brënda dhe jashtë vendit, eksport, import. Tregtimi me shumicë dhe pakicë i produkteve industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, pyjore, të ndërtimit, bimëve medicinale, eksport – import i tyre.
 - ◆ Projektim në fushat gjeologo – minerale, gjeologo – inxhinjerie etj.

Sa më sipër i kërkoj kësaj gjykate që, në bazë të ligjit 7667 datë 28/01/1993 dhe ligjit 7638 datë 19/11/1992, të regjistrojë shoqërinë "KLOSI" Sh.p.k. si person juridik.

Tiranë më 6.02, 1999

KËRKUESI

Nazif Klosi

